

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Nr.6

Qershor 2021

TRAJTOHET ANKESA E 1000-TË NË ILD

Në dt.18 Qershor u shqyrtua ankesa e njëmijte në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky është një moment i rëndësishëm efektiviteti e transparence, për një institucion krejt të ri, i ngritur vetëm 16 muaj më parë, e që ka mbi 3700 kërkesa të depozituara për gjyqtarë e prokurorë, pjesa më e madhe, e përcjelle nga institucione, që i kanë akumuluar ndër vite, si Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministria e Drejtësisë.

Shqyrtimi i ankesave bëhet sipas një metodologjie pune të miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (Urdhër nr.65, datë 28.09.2020, Urdhër nr.66, datë 28.09.2020 dhe Urdhër nr. 98, datë 12.11.2020), që lidhet me mënyrën e rivlerësimit, kategorizimin dhe nivelin e përparësisë në trajtim. Dhënia e një përgjigje në kohë sa më të shpejtë qytetarëve për ankesat e tyre, pavarësisht kohës apo institucionit ku e kanë paraqitur, mbetet prioritare për zyrën e ILD-së.

Zyra e ILD-së ka krijuar lehtësi për procesin e ankimimit, i cili mund të kryhet në tri mënyra. Ankesa mund të paraqitet elektronikisht, duke plotësuar e dërguar me e-mail formularin e ankesës, që gjendet në faqen zyrtare të ILD; përmes



postës ose duke u paraqitur personalisht pranë Zyrës së ILD, për të plotësuar e dorëzuar formularin. Procesi i dorëzimit të ankesave pranë ILD bëhet cdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, nga ora 09:00-14:00. Cdo ankues, nëse ka nevojë, asistohet nga punonjësit e Sektorit të Ankesave.

Në funksion të angazhimit të institucionit për të bërë transparencën e veprimtarisë së tij, në faqen zyrtare të ILD pasqyrohen dhe përditësohen cdo të hënë, shifrat e ankesave të mbërritura pranë ILD, ato të trajtuara, ankesat në proces trajtimi e në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar, si dhe numri i vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillim hetimi disiplinor dhe numri i kërkesave për procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve e prokurorëve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë nxit qytetarët, institucionet, median e organizatat e shoqërisë civile, që të vijojnë të kontribuojnë në denoncimin e fakteve apo shkeljeve që mund të kryhen nga ana e magjistratëve.drejtë e çdo individ.



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

ANKIMI NË ILD EDHE MË I THJESHTË!

Për të lehtësuar edhe më shumë procesin e ankimimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sjell një formë të re, më të thjeshtuar të ankesës, që qytetarët apo institucionet mund të paraqesin për shkelje të dyshuara nga ana e magjistratëve, gjyqtarë a prokurorë.

Forma e re e ankesës gjendet tashmë në faqen zyrtare të ILD-së, me udhëzuesin përkatës dhe një shembull konkret plotësimi të saj.


Në rubrikën e posacme të ankesave të interesuarit mund të mësojnë mbi mënyrën se si pranohen ankesat nga Zyra e Inspektorit të Lartë të

Vijon në fq.2

Drejtësisë, mënyra dhe afatet kohore të trajtimit të tyre, si dhe shembuj konkretë të kësaj mënyrë trajtimi.

Çdo qytetar apo institucion i interesuar ka disa mënyra për të paraqitur ankesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet:

- Plotësimi online të formularit të ankesës, që gjendet në faqen zyrtare të ILD-së.
- Dërgimit me postë të formularit të ankesës në adresën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Dorëzimit personalisht të ankesës në ILD, e plotësimi të formularit, në rast nevojë me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.



Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbetet i përkushtuar ndaj standardeve më të mira, transparencës dhe lehtësive për çdo ankues, qoftë qytetar apo institucion, në drejtim të verifikimit e trajtimit të ankesave në një kohë sa më të shpejtë, si dhe hetimit të shkeljeve disiplinore të cdo magjistrati në vend.

“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

STATISTIKA

Gjatë muajit **Qershor**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **140 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione.

Konkretisht:

134 ankesa janë depozituar nga qytetarët;

6 ankesa kanë ardhur nga institucione publike dhe jopublike. **31 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre apo asistencë në plotësimin e formularëve. **31 takime** me ankues, të cilët janë asistuar gjatë plotësimi të formularëve të ankesave në ambientet e ILD. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Qershor 2021. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si; shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projekt-vendimet përkatëse.



SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre. Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217

11 MUAJT E PARË TË ILD, NJË RRUGË E MIRË E SHTRUAR PËR TË ARDHMEN

Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqiti më 3 Qershor në Kuvend raportin e punës për vitin 2020.

Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Kuvend:

“Eshtë kënaqësi të paraqes para jush raportin e parë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të vitit 2020, që përfshin 11 muajt e parë të punës. Do përpiqem të jem konciz për t’ju kursyer kohë, në kushtet kur raportin e plotë e dispononi të gjithë.

Inspektimi i punës së cdo magistrati në Republikën e Shqipërisë, një praktikë që ka ekzistuar e ndarë në institucione të vecanta, ka marrë një dimension të ri, përmes një institucioni të pavarur me Kushtetutë, sic është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ngritur më 1 Shkurt 2020.

ILD shqyrton, verifikon, heton dhe procedon cdo gjyqtar e prokuror në Republikën e Shqipërisë, që dyshohet se ka kryer shkelje



“5 vjet pas miratimit të reformës është koha që qytetarët të shohin rezultate, sepse forcimi i pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor është jetik për të patur një sistem funksional, të paanshëm, me integritet dhe me fokus qytetarin. Këto janë bazat e një shteti ligjor të fortë dhe demokratik, të cilin e duam të gjithë”

disiplinore. Sipas ligjit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vihet në lëvizje bazuar në ankimin me shkrim të cdo personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar, përfshi Ministrin e Drejtësisë; Prokurorin e Përgjithshëm; anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; kryetarët e gjykatave, drejtuesit e zyrave të prokurorive, si dhe me iniciativë të vetën.

Duke qenë një institucion krejt i ri, e kam konsideruar prej fillimit një sfidë personale e institucionale, ndërtimin dhe zbatimin e standardeve e parimeve më të mira, pa

u ndikuar nga vullnetet a subjektivizmat e castit, apo nxehtësia e debatit të momentit, por duke i parë çështjet në parim të tyre dhe në themel të ruajtjes së një balance të rëndësishme të tyre.

Fillimi nuk ka qenë aspak i lehtë, pasi si një institucion që u ngrit nga e para, kemi patur sfida nga më baziket, që nga pajisja me zyra e staf të përkohshëm, rregullimi i veprimtarisë ligjore, strukturore e fizike, hartimi e konceptimi i mënyrës së aplikimeve e rekrutimeve, tek plotësimi i organikës në mungesë ambientesh pune, e deri tek përballja, që në ditët e para,

me një fluks dosjesh të trashëguara. Kushtëzimet që erdhën nga pandemia Covid-19, ishin një tjetër element i shtuar vështirësie, si për cdo institucion tjetër në fakt, por që konkretisht tek ILD, solli pezullimin e konkurseve e procesit të rekrutimeve.

Në vitin e parë të punës, ILD ka patur vetëm 1 inspektor magistrat, të trashëguar nga ish KLD dhe me procesin e brendshëm të rekrutimeve jemi mbështetur tek ndihmës inspektorët. Organika parashikon 13 inspektorë magistratë, që përzgjidhen nga KLGJ e KLP dhe 13

inspektorë jo magjistratë, një proces ende i papërmbyllur për arsye subjektive, që lidhen kryesisht me mungesë interesi pas thirrjeve për kandidim, që bëjnë sipas ligjit Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Sa për statistikë, numri i dosjeve të përcjella në ILD nga institucione, si Këshilli i Lartë i Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm e Ministria e Drejtësisë, por edhe vetë ankesa të ardhura që prej ngritjes së Institucionit deri në dhjetor 2020, e kalon shifrën 3 mijë e 54. (2104 të transferuara dhe 950 të depozituara në ILD prej 1 shkurtit deri më 31 dhjetor 2020. Janë miratuar 184 vendime dhe trajtuar 1347 praktika).

Duke qenë një person që më pëlqen ta shoh gotën gjysëm plot, nuk do ndalem tek vështirësitë, por tek puna që kemi bërë, pavarësisht tyre.

Që në ditët e para të marrjes së detyrës, kam shpallur si prioritet të rëndësishëm, verifikimin e lirit me kusht të personave të dënuar. Ishte një çështje që kishte ndjeshmëri dhe interes të lartë publik. Dua të ndaj me ju faktin se me vetëm 1 inspektore magjistrate në dispozicion, në 11 muajt punë në vitin 2020 është bërë një punë voluminoze. Duke

patur parasysh se cdo kërkesë që mbërrin në institucion, kalon në disa etapa me afate kohore pune, që janë “shqyrtimi”, “verifikimi”, “hetimi” e “procedimi disiplinor”, gjatë vitit 2020 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 8 vendime për fillimin e hetimit disiplinor (2 prokurorë dhe 6 gjyqtarë). 5 prej tyre (një magjistrat-prokuror dhe 4 magjistratë-gjyqtarë) janë hetime të iniciuara kryesisht nga ILD dhe 3 të tjera (magjistratë-gjyqtarë), janë hetime të iniciuara nga rastet e paraqitura nga institucione. (2 MD, 1 KPK). Pra në periudhën shkurt-dhjetor 2020 janë formuluar 4 kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor, 3 pranë KLGJ e 1 pranë KLP. Gjatë kësaj periudhe raportimi, KLGJ pranoi kërkesën e ILD për shkarkimin e një magjistrati gjyqtar, ndërsa KLP rrëzoi kërkesën e ILD për masë ndaj një magjistrati prokuror, vendim të cilin ILD e ka ankimuar.

Ky është një bilanc, që e vlerësojmë të rëndësishëm për kushtet tona, si një rrugë e mirë e shtruar për të ardhmen.

Nga ana tjetër, zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka një vëmendje të posacme për kërkesat që vijnë nga qytetarët. Që prej 1 shkurtit deri në 31 Dhjetor janë 756 ankesa nga qytetarët. Në kushtet e pandemisë dhe të

qenit një institucion i ri e pa infrastrukturë, shifra tregon një interesim të konsiderueshëm.

Pritshmëria e qytetarëve është e lartë dhe kjo na imponon seriozitet dhe angazhim maksimal. Duke e lexuar këtë qasje të publikut, kemi krijuar lehtësi në paraqitjen e ankesave nga qytetarët. Ankesat mund të bëhen online përmes një formulari që gjendet në faqen e ILD-së, bashkë me udhëzuesin për plotësimin e tij, një proces që kursen kohë. Ankesa mund të bëhet edhe pranë institucionit të ILD-së, ku stafi i posacëm asiston cdo qytetar në procesin e plotësimit të formularit të ankesës dhe rruga e tretë është ajo me postë. Pra gjithcka, që qytetari të ketë aksesin e duhur, për cdo pretendim për të drejtën e cënuar.

Puna jonë do të vazhdojë me synime dhe qëllime të qarta, me efekt vendosjen e standardeve mbi mënyrën e verifikimit të ankesave, trajtimit të tyre në një kohë sa më të shpejtë dhe hetimin kryesisht të shkeljeve disiplinore, një proces që paraqet një rëndësi të veçantë, për efekt të rritjes së përgjegjshmërisë së gjyqtarëve e prokurorëve në ushtrimin e detyrës së tyre, rritjes së besimit të publikut tek organet e sistemit gjyqësor, rritjes së cilësisë së shërbimit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, etj. Për një orientim të qartë, ILD ka

hartuar me konsultim të gjerë dhe miratuar tashmë “Strategjinë dhe planin e veprimit dy vjeçar” me objektiva strategjike që lidhen me pavarësinë, eficientë e profesionalizmin e Zyrës së ILD-së; zhvillimin e procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standartet ndërkombëtare; pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe bashkëpunimit institucional si dhe rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në vizionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, inspektimi nuk duhet parë si një çekan ndaj prokurorëve e gjyqtarëve. Padyshim, ata që kanë bërë shkelje duhet të kenë frikë sot e gjithë ditën, por e rëndësishme është gjetja e bal-

ancës së duhur mes interesit publik për të monitoruar e parë administrimin e drejtësisë nga gjyqtarët e prokurorët, me ndarjen e pushteteve, edhe me atë që është pavarësia e gjyqtarëve dhe e prokurorëve.

Jam i ndërgjegjshëm se përm-bushja e objektivave që i kemi vënë vetes do kërkojë kohën e vet, e sidomos një bashkëpunim më të gjerë me institucione e mekanizma të ndryshëm kombëtarë e ndërkombëtarë. Nga shqyrtimi, Drejtësisë është i hapur për bashkëpunimin e kontributin e të tek procedimi disiplinor, synimi i zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbetet ndryshimi rrënjësor i konceptit të inspektimit, për të unifikuar stand-ardet më të mira të drejtësisë për të gjithë. Me kënaqësi kam konstatuar se kjo ide është bash-

këndarë nga takimet e punës me institucionet e tjera të rëndësishme, si me KLGJ e KLP dhe PP. Është një vizion, të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë do e ndajë edhe në inspektimet tematike, që zhvillohen në cdo gjykatë e prokurori në vend.

Në mbyllje, do doja të falenderoja kuvendin e posacërisht Komisionin e Ligjeve për mbështetjen dhe inkurajimin ndaj ILD-së. Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i hapur për bashkëpunimin e kontributin e të gjithëve, për finalizimin e synimit të përbashkët, për të cilin u realizua një reformë madhore kaq e thellë: një drejtësi e barabartë për të gjithë.”.

[Klikoni për të ndjekur intervistën e plotë.](#)

METANI: GJYQTARI DUHET TË KETË STANDARDE TË LARTA TË SJELLJES BRENDA DHE JASHTË FUNKSIONIT SI MEKANIZËM PËR BESUESHMËRI PËR ÇDO VENDIM GJYQËSOR QË JEP

KLGJ pranoi në datën 7 Qershor kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra deri në përfundim të procesit disiplinor të E.K., magjistrate në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan dhe i kërkoi ILD-së kryerjen e hetimeve të mëtejshme për shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistrates.

Më 30.05.2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani ka filluar me iniciativën e tij, një hetim disiplinor ndaj magjistrates E.K., me detyrë Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ushtron njëkohësisht detyrën e Kryetares së kësaj gjykate. Hetimi

nisi pas publikimit gjerësisht në median e shkruar, atë vizive dhe në rrjetet sociale, të disa videove, që mbanin logon e rrjetit social “Tik Tok”, ku shfaqej magjistratja E.K., shfaqej në ambientet ku ushtron detyrën dhe brenda një automjeti, me sjellje provokuese, shoqëruar në sfond me muzikë të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati.

Në parashtresën para anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha mes të tjerash, se nga hetimi disiplinor provohet, se nga ana e magjistrates E.K janë kryer sjelleje në kundërshtim me parimet e



integritetit të magjistratit dhe parimit të sjelljes së hijshme dhe me vetëpërbajtje, të parashikuara në Kodin e Etikës Gjyqësore. Sjelljet dhe veprimet e magjistrates të kryera jashtë ushtrimit të detyrës, por edhe në ambientet e ushtrimit të detyrës, diskretitojnë figurën dhe pozitën e magjistratit dhe dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, duke u parashikuar si *shkelje shumë e rëndë disiplinore*.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani nënvizoi se “Gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t’i respektojë personalisht këto standarde, si gjatë ushtrimit të detyrës ashtu edhe në jetën private. Gjyqtari duhet të transmetojë përvecse drejtësi, edhe besueshmëri e etikë të lartë, integritet në dhënien e një vendimi gjyqësor.

E për ta përmbushur, sjellja e tij duhet ta reflektojë këtë në cdo aspekt të punës dhe jetës së tij.” Bazuar në konkludimet e hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani i propozoi Këshillit të Lartë Gjyqësor, *pezullimin nga detyra* të magjistrates E.K., deri në përfundimin e procedimit disiplinor dhe masën disiplinore **“Shkarkim nga detyra”** të parashikuar nga neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neni 103, paragrafi 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 171, datë 22.04.2021: Seksionit “C” “Parimi i integritetit”, shkronja “a” dhe “b”, Seksioni “Ç” “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërbajtje”, pika 9, shkronja “c”.



Inspektori i Lartë i

Drejtësisë citon në

llogarinë zyrtare

Twitter:

“Pa dyshim mua më intereson shumë ajo që shkruhet në media, sepse dua të shoh perceptimin për vendimarrje të caktuara apo për çështje të caktuara që trajtohen. Mendohem të mos bie pre e presionit, si për mirë, si për keq. Por, bindjen time personale të bazuar në ligj, unë nuk e negocioj me asgjë. Me asnjë artikull apo deklaratë publike.”



METANI: BINDJEN TIME PERSONALE TË BAZUAR NË LIGJ, UNË NUK E NEGOCIOJ ME ASGJË



Në datën 10 Qershor, Inspektori i Lartë të Drejtësisë Z. Artur Metani dha një intervistë për gazetarin Mustafa Nano, emisionin “Armatistan”, në MCN TV.

I pyetur për ndjesitë mbi funksionin që mban prej gati 16 muajsh, z. Metani e krahasoi me një sfidë plot të papritura e kënaqësi, por edhe peshë e madhe morale e profesionale, mes atyre që e besuan dhe sidomos pritshmërinë e qytetarëve. “Mbi të gjitha është një peshë e madhe nga e gjithë shoqëria shqiptare, që pret rezultate të dukshme, të shpejta nga këto institucione të reja, sic është Inspektori i Lartë i Drejtësisë.”

Duke folur për reformën në drejtësi dhe ecurinë e saj, Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha se është një proces, që ka nevojë për kohë të provojë veten, por edhe kërkon angazhim jo vetëm nga institucionet, por edhe nga qytetarët. “Unë mendoj, që për të patur sukses reforma dhe institucionet e reja të drejtësisë, nuk është një gjë që varet nga puna e Artur Metanit, apo nga puna e prokurorëve që punojnë në SPAK apo kolegëve që punojnë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e

Lartë të Prokurorisë. Drejtësia është një koncept që është dinamik, është i gjallë dhe ushqehet nga të gjithë ne, brenda sferës dhe detyrimit që kemi si qytetarë. Pa dyshim, pjesa më e madhe i takon Arturit, Arben Krajës, te Spaku e kështu me radhë dhe të gjithë zyrtarëve, që punojnë gjithandej, por edhe ne qytetarët, pra edhe si qytetar po e fus veten, kemi ato detyrimet tona që kur edukojmë fëmijët tanë: mos kopjo se është gabim, mos parko gabim, s’do futet babi mik për dy nota tek mësuesja, s’do paguajë lekë babi për shkollën. Të gjitha amplifikohen dhe vijnë pastaj tek pjesa që kërkojmë drejtësi, për një gjë që vetë s’e kemi bërë, që kur kemi qenë të vegjël. Pra, dua të them që të gjithë duhet ta ndihmojmë drejtësinë të zhvillohet.

Nuk është një punë që varet thjesht nga puna e institucionit, por nga të gjithë ne. Edhe nga gazetarët, mendoj unë. Është një koncept që ka nevojë për gjak, për ushqim dhe për dashuri.”, tha z. Metani.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë foli



për inspektimet tematike, prioritetin e shpallur tashmë të institucionit që drejton, për të identifikuar e trajtuar fenomenet që hasen nëpër gjykatat e prokuroritë e vendit.

I pyetur për rastin e magjistrates nga Elbasani, për të cilën ILD ka kërkuar pezullim dhe shkarkim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, z. Metani tha se mirëkupton sensibilitetet e ndryshme publike, por vepron mbi bindjen e bazuar në ligj, mbi sjelljen që duhet të ketë një zyrtar në publik, e akoma më tepër një magjistrat, që vendos për jetën e të

tjerëve. “Për këtë arsye, ti duhet të jesh shumë rigoroz në sjelljet e tua, duhet të vetëpërbahesh e duhet të heqësh dorë nga shumë gjëra, që të tjerët mund t’i bëjnë shumë lirisht, edhe pse mund të jetë brenda sferës private. Është domosdoshmëri pikërisht për këtë efekt, që krijon tek qytetarët vendimarrja jote.”

Reagimi i ILD-së ishte i shpejtë tha z. Metani, sepse publiku e meritonte një përgjigje të shpejtë, nga institucionet që e kanë detyrim e për pasojë edhe pse kam vëmendje për perceptimet që përcillen në publik, vendimarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e lidh vetëm me ligjin e asgjë tjetër. “Bindjen time personale të bazuar në ligj, unë nuk e negocioj me asgjë. Me asnjë artikull apo deklaratë publike.”, u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

[Kliko](#) për të ndjekur intervistën e plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KLJG PRANON KËRKESËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR SHKARKIMIN E MAGJISTRATIT K.S

Këshilli i Lartë Gjyqësor në seancën e datës 2 Qershor pranoi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të magjistratit K.S.

Në seancën dëgjimore në KLJG Inspektori i Lartë Metani tha se “në analizë të dokumentacionit të administruar në kuadër të këtij procesi disiplinor, rezultoi se gjyqtari K.S., me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (nr. 69, datë 29.10.2019), lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë (nr. 19, datë 21.09.2020) është deklaruar fajtor për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç të K.Penal. Në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor si dhe të pranuar nga gjykata rezultoi se nga ana e



magjistratit K.S. janë ndërmarrë veprime aktive me anë të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë, veprime të cilat janë vlerësuar se përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, të

kryera gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje direkte dhe me qëllim përfitim të parregullt prej tyre, duke favorizuar njërën palë ndërgjyqëse nëpërmjet dhënies së vendimi gjyqësor civil në favor të tij.

Në parashtrim të konkluzioneve, z.Metani u shpreh se “Veprimet e magjistratit K.S. kanë cenuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm, por edhe nga veprimet e vetë atyre si funksionarë të drejtësisë. Këto veprime kanë cenuar besimin e palëve ndërgjyqëse dhe të publikut në organet e drejtësisë dhe respektimin e ligjit nga ana tyre, si dhe kanë diskretituar rëndë pozitën dhe

figurën e magjistratit. Ushtrimi i pa rregullt i detyrës nga ana e magjistratit K.S. ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.” Për pasojë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani kërkoi nga KLGJ administrimin e provave të paraqitura prej tij në këtë procedim disiplinor, pranimin e kërkesës së ILD për fillimin e procedimit disiplinor dhe caktimin ndaj magjistratit K.S. të masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, kërkesë që u pranua nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

JEMI ENDE LARG ASAJ QE PRITET PREJ NESH, POR EDHE NE PREJ VETES



Në datën 23 Qershor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani mori pjesë në eventin e organizuar nga Komiteti i Helsinkit, për paraqitjen e rezultateve të monitorimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku foli për sfidat e reformës në drejtësi dhe rolin e shoqërisë civile.

Fjala e rastit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

Faleminderit për ftesën dhe për organizmin e këtij aktiviteti.

Zhvillimi i këtij takimi, si dhe diskutimi lidhur me veprimtarinë e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, veçanërisht në fazën e parë të Këshillit të Lartë të Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përbën në vetvete një tregues të qartë, se Reforma në Drejtësi ka nisur rrugëtimin e saj. Dhe rezultatet e këtij monitorimi dhe raporti, tregojnë qarte se ky rrugëtim tashme nuk ka më kthim pas. Kjo reforme përbën një nga ndërmarrjet më të mëdha për demokracinë dhe shtetin e së drejtës në Shqipëri. Është një nga reformat më të thella kushtetuese, ligjore dhe institucionale, që ka prekur sistemin e

drejtësisë jo vetëm në vendin tonë, por padyshim nder reformat me të thella krahasuar edhe me sisteme të tjera drejtësie. Jetësimi i reformës, i organizimit të ri kushtetues të sistemit të drejtësisë, i kompetencave të reja, dhe për me tepër i filozofisë së re të ushtrimit të këtyre kompetencave, nuk është aspak e lehtë. Jo thjesht se ngritja dhe venia në funksionim e institucioneve të reja ishte dhe ende mbetet një sfidë për shumë arsye, disa jo edhe në mundësi dhe doren e institucioneve të reja. Por, reforma në drejtësi, është një proces transformimi, i cili kërkon kohën e vet për të realizuar qëllimin për të cilin ajo u ideua dhe hartua. Megjithatë, unë mendoj se organet e reja të drejtësisë kanë filluar të funksionojnë, kanë filluar të ushtrorjnë kompetencat e tyre në masën me të madhe të tyre, kanë filluar dhe të japin rezultate konkrete. Dhe natyrisht, këtu nuk është vendi për të evidentuar arritje, pasi nuk është as koha, as vendi dhe as faza në të cilën ndodhet procesi i zbatimit të reformës në drejtësi. Jemi ende larg asaj që pritet prej nesh, por edhe ne prej vetes. Por, unë mendoj se është vendi të thuhet se






një mbikëqyrje efektive, duhet një edhe bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet organeve të reja të sistemit të drejtësisë dhe organizative të shoqërisë civile. Bashkëpunimi është një proces i domosdoshëm, e që kërkon vullnet të dyanshëm: edhe institucionet të jete të hapura për këtë bashkëpunim, por edhe

procesi i reformimit të sistemit të drejtësisë dhe funksionimi i organeve të reja, efikasiteti dhe suksesi i tyre dhe ne teresi i zbatimit të drejtës në Shqipëri, kërkon mbështetjen dhe bashkëpunimin intensiv dhe të vazhdueshëm ndërmjet vete këtyre organeve, por edhe të akademikëve, ekspertëve, organizatave të shoqërisë civile, medias dhe partnerëve tanë ndërkombëtare si BE dhe SHBA, të cilat e kanë mbështetur këtë reformë jo vetëm financiarisht, por edhe në krijimin dhe zbatimin e një menyre të re të menduar apo mentaliteti të ri, me qëllim ndryshimin e kulturës së korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në Shqipëri. Në këtë kuptim, e vlerësoj se tepërmi një aktivitet si ky i sotmi, pasi roli i shoqërisë civile mbetet i pazevendësueshëm, në të gjithë këtë proces në vecanti, por edhe në funksionimin e shtetit të drejtës në përgjithësi. Organizatat e shoqërisë civile paraqesin një mënyrë alternative të mbrojtjes së interesave të qytetarëve, këndvështrime të ndryshme, presionin pozitiv ndaj vendimmarrësve dhe drejtuesve të organeve të reja të drejtësisë, mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre dhe me të drejtë edhe kërkimin e përgjegjësisë nga këto organe. Në të njëjtën kohë, mendoj se ky proces mbikëqyrje mund të mos fokusohet vetëm në rrafshin e identifikimit të problemeve dhe dhënies së rekomandimeve. Qasja kritike dhe identifikimi i problematikave është vetëm një mjet. Në rastin konkret në kuadër të

organizatave të shoqërisë civile duhet të ofrojnë këtë bashkëpunim. Kam besim se vetëm nëpërmjet funksionimit të plotë të organeve të reja të sistemit të drejtësisë, angazhimit të plotë të organizatave të shoqërisë civile, të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, do të bëhet e mundur një zbatim efikas në praktikë i Reformës në Drejtësi, bazuar në profesionalizëm dhe të ngritur mbi parimet e llogaridhënies dhe pavarësisë, aksesit për të gjithë, dhe mbi të gjitha, edhe për çfarë shërbeu si shtysë për konceptimin e kësaj Reforme, kthimin e besimit të publikut në drejtësi. Personalisht jam i bindur se gjetjet e këtij raporti monitorimi janë një pikënisje shumë e mirë, për një analizë të plotë të gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të organeve të reja të sistemit të drejtësisë, me qëllim evidentimin e problematikave, të cilat janë kanë ardhur si pasojë e ushtrimit të kompetencave gjatë veprimtarisë fillestare, si dhe nevojave për përmirësim në të ardhmen. Duke falënderuar znj. Skëndaj dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, në lidhje me monitorimin e procesit të ngritjes dhe funksionimit të organeve të reja të sistemit të drejtësisë, gjej rastin të përgëzoj gjithashtu për punën e bërë dhe rezultatet e arritura, edhe kolegët e mi Znj. Llagami dhe Z. Ibrahim, si dhe anëtarët e Këshillave, të cilët janë angazhuar maksimalisht, në ushtrimin e detyrave të tyre gjatë kësaj periudhe. [Kliko për të ndjekur fjalën e plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.](#)



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NIS BASHKËPUNIMIN ME INSPEKTORATIN E PËRGJITHSHËM TË DREJTËSISË SË FRANCËSË


Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani zhvilloi një takim pune online në dt. 24.06.2021 me Inspektoratin e Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës mbi nisjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve. Z. Metani falenderoi Komisionin Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, CEPEJ për organizimin e takimit, si pjesë e bashkëpunimit të nisur tashmë me ILD-në. Shefi i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës z. Jean-François Beynel shprehu kënaqësinë për vendosjen e kontakteve dhe bashkëpunimin e ardhshëm e konkret me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë.

Duke falënderuar homologun francez z. Beynel dhe ekipin e tij për vullnetin e shprehur për këtë bashkëpunim, Z. Metani shprehu kënaqësinë, që institucioni i parë homolog evropian, me të cilin ILD do të bashkëpunim do të jetë ai i Francës, për të shkëmbyer përvoja konkrete në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve për standardet më të mira të drejtësisë për qytetarët.

Qershor 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë


© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri



 [Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)  [Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/Inspektori%20i%20Lart%C3%AB%20i%20Drejt%C3%ABs%C3%ABs%C3%AB)



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com/Inspektori%20i%20Lart%C3%AB%20i%20Drejt%C3%ABs%C3%ABs%C3%AB)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)